



OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË  
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 11

03 shkurt 2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Relievi i trevave shqiptare është i shumëllojshëm.

Analizoni tipat gjenetikë të relievit të trevave shqiptare si: relievin strukturor, lumor, karstik, akullnajor dhe atë denudues. 10 pikë

*Relievi strukturor:*

Ky reliev është nga më të përhapurit në Shqipëri. Dallohen strukturat nga më të thjeshtat deri tek ato më të ndërlikuarat. Shumëllojshmëria e formacioneve shkëmbore kanë përcaktuar tiparet e këtij tipi të relievit.

Strukturat mbizotëruese në këtë tip të relievit janë ato shkëputëse të llojit horst-graben dhe në përhapje më të vogël strukturat rrudhosëse (antiklinal-sinklinal). Horstet përfaqësojnë ngritjet e relievit, malet ndërsa grabenet përfaqësojnë gropat dhe fushëgropat.

*Relievi lumor*

Relievi lumor në Shqipëri përfaqësohet nga rrjeti i dendur i luginave të lumenjve të cilat gërryejnë territorin kryesisht nga juglindja në veriperëndim. Format më të përhapura të këtij relievi janë luginat lumore, në formimin e të cilave ka ndikuar dhe ndryshimi i klimës. Luginat tona lumore në rrjedhën e sipërme janë tipike malore, në rrjedhën e mesme ato zgjerohen ndërsa në rrjedhën e poshtme ato e humbasin karakterin e tyre duke u njësuar me fushat perëndimore. Forma të tjera të relievit lumor janë dhe tarracat lumore dhe kanionet.

*Relievi karstik*

Edhe ky reliev ka përhapje të gjerë për shkak të shtrirjes së madhe të formacioneve karbonatike dhe të kushteve të tjera natyrore për zhvillimin e proceseve kimike të tretjes. Karsti në vendin tonë është i tipit mesdhetar dhe relievi karstik dallohet për forma të larmishme dhe origjinale. Ndër format më të njohura të relievit karstik janë: gropat, hinkat karstike sipërfaqësore në formë të hojeve të bletëve si në Malin me Gropa, Malin e Thatë etj, por nuk mungojnë liqenet me origjinë karstike si dhe format e relievit karstik nëntokësor.

*Relievi akullnajor*

Ky reliev në krahasim me format e tjera të relievit në vendin tonë zë një vend më të vogël. Kjo lidhet me pozitën gjeografike të vendit tonë si dhe lartësinë e vogël dhe mesatare të relievit. Format kryesore të relievit akullnajor të krijuara nga gërryerja e akujve janë luginat akullnajore, lugjet, gropat, cirqet akullnajore etj. Format e krijuara nga veprimtaria grumbulluese e tyre janë morenat akullnajore.

*Relievi denudues*

Ky lloj i relievit në vendin tonë lidhet ngushtë me proceset e erozionit dhe proceset e shpatit. Vendi ynë ka kushte që mundësojnë zhvillimin e këtij relievi si: kushtet e klimës mesdhetare, ndërtimi gjeokogjik, veçoritë e relievit, mbulesa bimore dhe veprimtaria e njeriut. Ndër format e këtij relievi janë konet e rëndësë ose denudimit, forma të ndryshme të krijuara nga rrëshqitjet, rrëzimet dhe shembjet. Relievi denudues është tipik i zonave malore dhe me pjerrësi të vendit tonë.

2. Shkruani një ese të mirë organizuar që përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

Tema e esesë: Migrimi i popullsisë drejt Rajonit Perëndimor të Shqipërisë pas vitit 1990.

10 pikë

**Detyrë:**

Të vlerësohet pozicioni gjeografik i Rajonit Perëndimor, si vend më i favorshëm për të jetuar e punuar.

Të analizohen arsyet e ardhjeve të shumta të popullsisë drejt Rajonit Perëndimor pas vitit 1990.

Të analizohet efektet e migrimit si në rajonin pritës edhe në rajonet nga ku largohet popullsia.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

3. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

**Tema e esesë: Shqipëria, një potencial i madh i zhvillimit të turizmit.**

**10 pikë**

**Detyrë:**

Të analizohen potencialet natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare.

Të ofrohen mundësitë dhe rrugët më të mira për zhvillimin e turizmit.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

4. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

Tema e esesë: Rajonet gjeografike të Shqipërisë.

10 pikë

**Detyrë:**

Të analizohen ndarja e Shqipërisë në 4 rajone gjeografike.

Të analizohet nëse duhet të ketë përputhje midis rajoneve gjeografikë dhe ndarjes së rajoneve sipas INSTAT.

Ky i fundit i ndan rajonet në: Rajoni Veri, Rajoni Qendër dhe Rajoni Jug.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

**Tema e esesë: Pasojat e rrezikshme të ndotjes së mjedisit i pësojmë të gjithë.**

**10 pikë**

**Detyrë:**

Të analizohet gjendja e mjedisit në Shqipëri.

Të ofrohen alternativa për mbrojtjen e mjedisit.

**Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:**

***Hyrja / prezantimi – 2 pikë***

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

***Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë***

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

***Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë***

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.